



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË**

PROJEKT-VENDIM

Nr. datë .12.2025

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM
2027– 2029 DHE BUXHETIN VJETOR 2027**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, gërma e), Ligjit Nr.68/2017“Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Kreu VII, neni 33-41, me propozim të Kryetarit të Bashkisë , Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës /12/2025

VENDOSI:

1. Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2027 si më poshtë:
 - Kalendar miratohet nga Këshilli jo më vonë se data 31 Dhjetor dhe hyn në fuqi ditën e parë të çdo viti buxhetor.
 - 03-31 Janar 2026 Kryetari i Bashkisë paraqet në Këshillin Bashkiak raportin e vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave për
Dy vitet e para të vitit buxhetor (2024-2025),
Vitin buxhetor 2026 dhe
Tre vitet e ardhshme 2027-2029;
 - Këshilli i Bashkisë miraton raportin e vlerësimit jo më vonë se data 1 Mars 2026.
 - Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe transfertave të pakushtëzuara,GMS dhe Drejtuesit e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve përgatitin tavanet e shpenzimeve në nivel programi dhe Këshilli i Bashkisë miraton tavanet e shpenzimeve për PBA 2027 – 2029 jo më vonë se data 15 Mars 2026.
 - Kryetari i Bashkisë pas miratimit në Këshill të tavanëve përgatitore të shpenzimeve deri në datë 20 Mars 2026 miraton udhëzimin e përgatitjes së PBA-së dhe e shpërndan tek njesitë shpenzuese në bashki;
 - Programi buxhetor afatmesëm miratohet nga Këshilli i Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë;
 - Brenda datës 01 Qershor 2026 Kryetari i Bashkisë i dërgon Ministrisë së Financave projekt dokumentin e PBA 2027– 2029.
 - Brenda datës 20 Qershor 2026 Ministria e Financave përgatit një raport me mendime mbi projekt dokumentin e PBA-së;
 - Projekti së bashku me mendimet zyrtare të Ministrisë së financave i paraqitet Këshillit të Bashkisë dhe brenda datës 30 Qershor 2026 Këshilli miraton projektin e parë të PBA-së duke shprehur opinionin e tij për rekomandimet e Ministrisë së Financave;
 - Brenda datës 05 Korrik 2026 Kryetari i Bashkisë merr masat për publikimin e dokumentit të parë të PBA;

- Bazuar në parashikimet e përditësuara të të ardhurave dhe transfertave , Kryetari i Bashkisë paraqet për miratim në Këshill tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA në nivel programi . Këshilli i Bashkisë miraton tavanet përfundimtare brenda datës 20 Korrik 2026;
 - Jo më vonë se 5 ditë nga miratimi i tavanëve përfundimtare Kryetari i Bashkisë nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të bashkisë dhe e shpërndan tek njesitë shpenzuese;
 - Pas marrjes së udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave , Kryetari i Bashkisë përgatit PBA-në e rishikuar ;
 - Në muajt Gusht – Shtator pas finalizimit të PBA-së së rishikuar, Kryetari i Bashkisë bën publikimin e tij dhe organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit dhe proces verbalet e takimeve bëhen pjesë e dokumentit të PBA;
 - Brenda 15 Shtator të vitit 2026, Këshilli i Bashkisë miraton PBA-në e rishikuar, bashkia dërgon në Ministrinë e Financave PBA-në e rishikuar së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga MF gjate fazës së parë;
 - Brenda datës 5 Tetor Ministria e Financave zhvillon seanca konsultimi me njesitë vendore;
 - Brenda datës 20 Tetor Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për tu reflektuar në dokumentin final të PBA.
 - Kryetari i Bashkisë brenda datës 30 Nëntor paraqet për shqyrtim dhe miratim projektin e PBA përfundimtar së bashku me mendimet e Ministrisë së Financave dhe vlerësimin e tij për marrje në konsideratë të tyre;
 - Gjithashtu Kryetari i Bashkisë paraqet në Këshill për miratim p/buxhetin vjetor jo më vonë se data 30 Nëntor i vitit buxhetor.
 - Projekt buxheti vjetor përmban vitin e parë të PBA;
 - Çdo anëtar këshilli mund të propozojë ndryshime të argumentuara të projekt-buxhetit të paraqitur nga kryetari.
 - PBA 2027-2029 përfundimtare miratohet nga Këshilli i Bashkisë jo më vonë se data 25 Dhjetor 2026.
 - Në rast se Projekt buxheti nuk miratohet nga Këshilli brenda datës 25 Dhjetor jo më vonë se data 5 Janar i vitit pasardhës Prefekti kërkon thirrjen e mbledhjes së dytë të Këshillit.
 - Në rast të mosmiratimit të buxhetit, Kryetari i Bashkisë zbaton procedurat për buxhetin e përkohshëm vendor
 - Jo më vonë se 15 ditë nga miratimi i buxhetit në këshill, Kryetari merr masa për publikimin e tij në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të bashkisë.
 - Jo me vonë se 5 ditë nga miratimi i buxhetit vjetor, dërgohet në Ministrinë e Financave.
2. Për zbatimin e Kalendarit të programit buxhetor afatmesëm ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, Njesitë shpenzuese dhe Këshilli i Bashkisë
 3. Ky projekt- vendim hyn në fuqi në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015.

**KRYETARI
ERION ISAI**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

**NËN KRYETAR
PETRO RISTO**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË

Nr. 7126 Prot

Datë 12 /12/2025

RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ ,datë ____ .12.2025

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM
2027– 2029 DHE BUXHETIN VJETOR 2027**

Drejtoria e Financës në bashkëpunim me drejtuesit e ekipeve të menaxhimit të programeve në zbatim të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Per Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, gërma e), Ligjit Nr.68/2017“Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Kreu VII, neni 33-41, për të zbatuar të gjitha fazat e hartimit dhe miratimit të PBA-së 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2026 ka hartuar dhe po çon për miratim kalendarin me afatet konkrete të çdo faze të përgatitjes së tij ,gjithashtu etapat që kalon hartimi dhe miratimi i tij deri në miratimin përfundimtar .Këto afate janë të detyrueshme për tu zbatuar nga e gjithë administrata dhe Këshilli i Bashkisë.

Kalendari i propozuar paraqitet si më poshtë :

- Kalendari miratohet nga Këshilli jo më vonë se data 31 Dhjetor dhe hyn në fuqi ditën e parë të çdo viti buxhetor.
- 03-31 Janar 2026 Kryetari i Bashkisë paraqet në Këshillin Bashkiak raportin e vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave për
Dy vitet e para të vitit buxhetor (2024-2025),
Vitin buxhetor 2026 dhe
Tre vitet e ardhshme 2027-2029,
- Këshilli i Bashkisë miraton raportin e vlerësimit jo më vonë se data 1 Mars 2026.
- Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe transfertave të pakushtëzuara GMS dhe Drejtuesit e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve përgatitin tavanet e shpenzimeve në nivel programi dhe Këshilli i Bashkisë miraton tavanet e shpenzimeve për PBA 2027 – 2029 jo më vonë se data 15 Mars 2026.
- Kryetari i Bashkisë pas miratimit në Këshill të tavanëve përgatitore të shpenzimeve deri në datë 20 Mars 2026 miraton udhëzimin e përgatitjes së PBA dhe e shpërndan tek njesitë shpenzuese në bashki;

- Programi buxhetor afatmesëm miratohet nga Këshilli i Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë;
- Brenda datës 01 Qershor 2026 Kryetari i Bashkisë i dërgon Ministrisë së Financave projekt dokumentin e PBA 2027 – 2029
- Brenda datës 20 Qershor 2026 Ministria e Financave përgatit një raport me mendime mbi projekt dokumentin e PBA;
- Projekti së bashku me mendimet zyrtare të Ministrisë së financave i paraqitet Këshillit të Bashkisë dhe brenda datës 30 Qershor 2026 Këshilli miraton projektin e parë të PBA duke shprehur opinionin e tij për rekomandimet e Ministrisë së Financave;
- Brenda datës 05 Korrik 2026 Kryetari i Bashkisë merr masat për publikimin e dokumentit të parë të PBA;
- Bazuar në parashikimet e përditësuara të të ardhurave dhe transfertave , Kryetari i Bashkisë paraqet për miratim në Këshill tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA në nivel programi . Këshilli i Bashkisë miraton tavanet përfundimtare brenda datës 20 Korrik 2026;
- Jo më vonë se 5 ditë nga miratimi i tavanëve përfundimtare Kryetari i Bashkisë nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të bashkisë dhe e shpërndan tek njesitë shpenzuese;
- Pas marrjes së udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave , Kryetari i Bashkisë përgatit PBA-në e rishikuar;
- Në muajt Gusht – Shtator pas finalizimit të PBA-së së rishikuar, Kryetari i Bashkisë bën publikimin e tij dhe organizon seanca dëgjimore me komitetin dhe grupet e interesit dhe proces verbalet e takimeve bëhen pjesë e dokumentit të PBA-së;
- Brenda datës 15 Shtator të vitit 2026, Këshilli i Bashkisë miraton PBA-në e rishikuar, bashkia dërgon në Ministrinë e Financave PBA-në e rishikuar së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga MF gjatë fazës së parë,
- Brenda datës 5 Tetor Ministria e Financave zhvillon seanca konsultimi me njesitë vendore;
- Brenda datës 20 Tetor Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për tu reflektuar në dokumentin final të PBA-së.
- Çdo anëtar këshilli mund të propozojë ndryshime të argumentuara të projekt-buxhetit të paraqitur nga kryetari
- PBA 2027-2029 përfundimtar miratohet nga Këshilli i Bashkisë jo më vonë se data 25 Dhjetor 2026.

- Në rast se Projekt buxheti nuk miratohet nga Këshilli brenda datës 25 Dhjetor jo me vonë se data 5 Janar i vitit pasardhës Prefekti kërkon thirrjen e mbledhjes së dytë të Këshillit.
- Në rast të mosmiratimit të buxhetit, Kryetari i Bashkisë zbaton procedurat për buxhetin e përkohshëm vendor,
- Jo më vonë se 15 ditë nga miratimi i buxhetit në këshill, Kryetari merr masa për publikimin e tij në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të bashkisë
- Jo më vonë se 5 ditë nga miratimi i buxhetit vjetor, dërgohet në Ministrinë e Financave.

Konceptoi: E.Josifi
Pranoi: G. Duka
Konfirmoi : O.Lifo

Specialiste Finance
Drejtore Finance
Drejtore D.Ç.J.P.P

KRYETARI
ERION ISAI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
NËN KRYETAR
PETRO RISTO

